SHP ÇAIR



## Turneu tradicional në shah

Në organizim të SHP Çair, më 29 tetor të vitit 2019, në Klubin e pensionistëve brenda Shtëpisë së pensionistëve në Fushën e Topanës, për të pestin vit me radhë, u mbajt turneu tradicional në shah mes shahistëve më të mirë nga Shoqatat e pensionistëve të Gazi Babës, Kisella Vodës, Ilindenit, Solidarnst-Aerodrom, Shoqatës së pensionistëve të luftës, Butelit dhe Çairit si nikoqir dhe organizator i shkëlqyeshëm i turneut.

Takimi filloi me kafe dhe lëngje për mirëseardhje të pjesëmarrësve në turne dhe gjithsesi fjalë përshëndetëse pati edhe nga kryetari i komisionit për sport dhe rekreacion pranë SHP Çair, Todor Iliev, i cili i përshëndeti të pranishmit në emër të kryetarit të shoqatës, i cili mungonte me arsye. Ai tregoi përfitimin nga shoqërimi i këtillë, ku ndërtohen shumë miqësi që zgjasin me vite. "Besoj se gara do të rrjedhë normalisht, dhe se nuk është me rëndësi kush do të jetë i pari. Me rëndësi është që të shoqërohemi, të marrim me vete përshtypje të mira dhe dëshiroj që nga këtu të dilni me së paku një mik më shumë", u shpreh në fjalimin e tij Todor Iliev.

Pastaj secili nga pjesëmarrësit në këtë turne tradicional të shahut mori vendin e vet në ekip në disiplinën më të vjetër të sportit, ku garojnë vetëm meshkuj. Garat janë zhvilluar në një atmosferë me analiza të shpeshta të disa lëvizjeve të suksesshme dhe lojërave, duke ju treguar garuesve për gabimet e bëra dhe duke i mbështetur ekipet e tyre. Nikoqiri, gjatë pauzës së shkurtë, të gjithë mysafirët dhe garuesit i shërbeu me një mëngjes të vogël. Gjithsesi, rezultatet asnjëherë nuk janë të rëndësishme, andaj edhe këtë herë gjithashtu. Ajo që është më e rëndësishme është shoqërimi dhe miqësia.

Megjithatë, në fund, sikurse në secilën garë, u shpallën fituesit. Vendin e parë me përparësi minimale e morën shahistët e SHP Solidarnost-Aerodrom, në vendin e dytë ishin shahistët e SHP Çair, ndërsa vendin e tretë e fituan shahistët e SHP Butel. Pastaj vendin e katërt e morën shahistët nga SHP Ilinden, vendin e pestë e morën shahistët nga SHP Gazi Babë, në vendin e gjashtë ishin shahistët nga SHP Kisella Vodë, ndërsa në vendin e shtatë ishin shahistët e Shoqatës së pensionistëve të luftës. *(Vasil Paçemski)*

SEANCA E PESTË E KE TË LSHPM

# PUNA E LIDHJES KA REZULTUAR ME ULJEN E TË DALAVE

Sipas praktikës së vendosur, kryetarja e Lidhjes, Trajkova ka përshëndetur mysafirët dhe anëtarët e pranishëm dhe ju referua aktiviteteve më të rëndësishme mes seancës së katërt dhe të pestë. Si ngjarje më të rëndësishme, ajo potencoi takimin me Kryeministrin Zoran Zaev dhe vendimin për rritjen e pensioneve në vitin 2020




Seanca e pestë e Këshillit ekzekutiv të Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë u mbajt më 15.11. 2019. Në mbledhje, krahas anëtarëve të këshillit morën pjesë edhe M-r Ilija Adamovski, kryetari i Kuvendit të LSHPM, Mitre Stojakovski, kryetar i Këshillit mbikëqyrës, kryetari i Komisionit për sport dhe rekreacion, Zdravko Petkovski, Dimitar Dimitrievski, koordinator i Delegacionit dhe grupet folklorike që kanë përfaqësuar Lidhjen në Lubjanë, dhe Petar Andreevski, kontabilisti i LSHPM.

Sipas praktikës së vendosur, kryetarja e Lidhjes, Trajkova ka përshëndetur mysafirët dhe anëtarët e pranishëm dhe ju referua aktiviteteve më të rëndësishme mes seancës së katërt dhe të pestë. Si ngjarje më të rëndësishme, ajo potencoi takimin me Kryeministrin Zoran Zaev dhe vendimin për rritjen e pensioneve në vitin 2020.

Pastaj seanca vazhdoi me shqyrtimin dhe miratimin e Raportit financiar për të hyrat dhe të dalat e Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë për periudhën janar-shtator të vitit 2019, me Raport të Këshillit mbikëqyrës. Për raportet, fjalitë e tyre hyrëse kishin Menka Temelkovska sekretare e KE dhe Mitre Stojanovski, kryetar i KM të LSHPM.

Në bazë të të dhënave të ofruara dhe diskutimit të të pranishmëve, është konkluduar se raportet janë përpiluar në mënyrë të qartë dhe profesionale dhe se në periudhën e theksuar Lidhja ka punuar në mënyrë ekonomike dhe me kujdes, që ka rezultuar me uljen e të dalave.

Pastaj u soll Vendimi për ndryshim dhe plotësim të Planit financiar të LSHPM për vitin 2019.

Raport për Garat e 24 Republikane sportive në vitin 2019, të mbajtura në Radovish parashtroi kryetari i Komisionit për sport dhe rekreacion Zdravko Petkovski, i cili ka potencuar se garat janë mbajtur në mënyrën më të mirë dhe pa probleme nën përkujdesin e Qeverisë dhe Ministrisë së punës dhe politikës sociale, në emër të së cilëve të pranishmit i përshëndeti zëvendësministri i punës dhe politikës sociale, Gjonul Bajraktar.

Raportin për pjesëmarrje të SHP Gazi Babë dhe SHP Vinicë në Festivalin e 19 Ndërkombëtar për gjeneratën e tretë të mbajtur në Lubjanë, R. Sllovenisë e ka parashtruar Dimitar Dimitrijevski i cili ishte koordinator i Delegacionit të grupit folklorik që kanë përfaqësuar LSHPM. Ai theksoi se këto dy grupe kanë patur shfaqje të shkëlqyeshme, se kanë patur nderin të marrin pjesë në hapjen solemne dhe se LSHPM ka marrë mirënjohje të posaçme për pjesëmarrjen 10 vjeçare të festivalit. Kalina. S. Andonova

## Delegacioni i LSHPM takoi Kryeministrin Zaev dhe ministren Carovska



Kryeministri i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev dhe ministrja e punës dhe politikës sociale, Mila Carovska u takuan me delegacionin e Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë, të udhëhequr nga kryetarja e Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë Stanka Trajkova. Në takimin, u bisedua për harmonizimin e pensioneve, si dhe çështje tjera nga aspekti i standardit të jetesës së këtyre qytetarëve.

Kryeministri Zaev dhe ministrja Carovska i informuan përfaqësuesit e Lidhje së shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë, që janë duke u realizuar kushtet për rritje të pensioneve në bazë të sistemit të stabilizuar pensional, rritjen e re të paralajmëruar të pagës minimale, rritjes së vazhdueshme të pagës mesatare, si dhe në bazë të rritjes së përgjithshme ekonomike në vendin, dhe që të gjithë këto faktorë, janë parakushte pozitive për rritje të pensioneve për rreth 700 denarë që nga 1 janari i vitit 2020, paralel për të gjithë pensionistët.

Në takimin me Kryeministrin Zoran Zaev dhe ministren për punë dhe politikë sociale, Mila Carovska, kryetarja e Lidhjes Stanka Trajkova, mes të gjithash, i potencoi edhe problemet në vijim: ndërtim të shtëpive për persona të moshuar dhe shtëpive për pensionistë për akomodim të popullatës më numrin më të madh në vend, avancimin e shëndetësisë dhe mbrojtjes shëndetësore si dhe nevojës për marrje edhe të kushteve të tjera të volitshme për një jetë më të mirë dhe më të dinjitoze të pensionistëve, për të cilën ishte përgjigjur që për kërkesat e parashtruara në periudhën e ardhshme do të kërkohen zgjedhje veçanërisht për përkujdesjen. (S.T)

SHP KUMANOVË

# Kumanova në zemër



Më 2 nëntor të këtij viti, SHP Kumanovë ka organizuar koncert tradicional "Kumanova në zemër" me rastin e festës së 11 nëntorit, Ditës së çlirimit ë qyteti. Sivjet është 75 vjetori i asaj dite, por edhe 500 vjetori i ekzistimit të qytetit të Kumanovës. Këto ishin dy shkaqet për festë të paharrueshme. Me këtë koncert, pensionistët e Kumanovës edhe njëherë dëshmuan se e duan qytetin e tyre dhe se e kanë në zemër. Koncerti filloi me himnin të cilin e këndoi kori pranë SHP Kumanovë nën udhëheqjen e Kosta Qose. Pastaj, kryetari i SHP Kumanovë, Bllage Jakimovski, i përshëndeti mysafirët e pranishëm, Zëvendëskryeministrin e Qeverisë dhe Ministrin e punëve të brendshme të Maqedonisë, Oliver Spasovski, kryetaren e LSHPM, Stanka Trajkova, nënkryetarin e LSHPM, Mentor Quku, Sekretarin e Komunës, Desanka Stoshevska, kryetarin SHP Leskovac dhe të tjerë, të cilët me prezencën e tyre kanë respektuar pensionistët dhe qytetin e famshëm të Kumanovës.

Aktorët pensionistë u paraqitën me një pjesë të dramës "Lençe Kumanovçe". Befasi e e këndshme për të pranishmit posaçërisht ishte shfaqja e seksionit të dramës të SHP Leskovac me një pjesë nga "Koshtana". Në këngën dhe vallen e tyre u bashkuan grupi folklorik pranë SHP Kumanovë nën udhëheqjen e Marjan Boshkovskit. Pasuria e folklorit, veshjet shumëngjyrëshe, vallja, qosteku i udhëheqësit të valles, muzika me shtatë të tetat, i mahniti të gjithë të pranishmit në sallë.

Koncerti përfundoi me himnin e qytetit, të cilin e këndoi kori i SHP Kumanovë në shoqëri me folkloristët. *G. Boshkovska*